



RREGULLORE PËR REVISTËN SHKENCORE THESIS KOSOVA

Neni I

Thesis Kosova është revistë shkencore me karakter ndërkombëtar, të cilën e themelon dhe e boton Universiteti AAB me seli në Prishtinë. Revista botohet katër herë në vit në gjuhët shqipe dhe angleze.

Neni II

Revistën e redakton Kryeredaktori bashkë me katër anëtarë të tjerë të Redaksisë të cilët i emëron Rektori i Universitetit AAB me mandat trevjeçar. Revista ka dhe një Sekretar të saj, të cilin e emëron Kryeredaktori.

Neni III

Revista ka edhe një Këshill redaktues të cilin e emëron Kryeredaktori në pajtim me Rektoren e Universitetit AAB.

Neni IV

Këshillin redaktues të revistës e përbëjnë tetë përfaqësues të Njësive Akademike të Universitetit AAB të cilët duhet të kenë titullin e doktorit të shkencave. Këshilli redaktues ka edhe tre anëtarë të tjerë nga bota akademike ndërkombëtare, të cilët i cakton Kryeredaktori në pajtim me Rektoren.

Neni V

Revista **Thesis Kosova** publikon punime shkencore të stafit akademik të Universitetit AAB, si dhe rezultatet e kërkimeve shkencore që arrijnë Qendrat Kërkimore të Njësive të tij Akademike. Ajo është e hapur edhe ndaj kontributeve shkencore të personave të tretë.

Neni VI

Revista **Thesis Kosova** financohet nga Universiteti AAB, si dhe nga donacionet e institucioneve të jashtme.



Neni VII

Kryeredaktori bashkë me redaksinë e revistës kanë për detyrë që në fillim të çdo viti akademik t'i paraqesin Rektorit projektin e punës për vitin vijues bashkë me raportin për vitin paraprak deri më 1 tetor.

Neni VIII

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Senati i Universitetit.

Rektori i Universitetit
Urosh Lipuscek

Prishtinë
25.09.2008